

VENDIM
Nr. 26, datë 3.6.2013

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS URA VAJGURORE

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellësit Ura Vajguore me:

Drejtues ligjor: Agim Veli Çunaj

Drejtues teknik: Evis Llambi Allajbe (Nikolla)

2. Operatori sh.a. Ujësjiellësi Ura Vajguore autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

3. Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Ura Vajguore, komuna Poshnje, fshatrat: Pashalli, Hallvaxhias, Skrean, Vokopol, Konizbaltë, Moravë.

4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 7.9.2016, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 20, datë 7.9.2012.

KRYETARI
Avni Dervishi